

## GJËRAT E FUNDIT TË NJERIUT

Nisim së bashku këtë cikël të ri në të cilin do të flasim rreth atyre që quhen “Gjërat e fundit të njeriut”, që janë pikërisht gjërat e fundit që ndodhin në jetën e një njeriu, e çdo njeriu të rruzullit tokësor, pavarësisht nga përkatësia fetare, kombëtare ose kulturore. Unë, ti, të gjithë, herët a vonë do të na duhet të përballemi me këto fenomene për të cilat do të flasim në këto faqe. Për këtë arsye, ju ftoj që t’i lexoni me vëmendje dhe t’i kushtoni kohë e rëndësi të madhe, sepse të dimë rreth këtyre gjërave do të thotë me të vërtetë të dimë rreth jetës sonë, rreth “fatit” tonë, rreth asaj që do të na ndodhë secilit prej nesh. Do të thotë me pak fjalë të kujdesemi për veten tonë! Në ditët tona i jepet shumë rëndësi gjërave materiale, ushqimit, punës, sikurse edhe trupit tonë, në veçanti mirëqënies së shëndetit tonë, duke harxhuar për to paratë dhe kohën që secili prej nesh e ka kaq të çmuar (jo më larg se dje një njeri tek i jepte makinës po çmendej sepse i kishin zgjatur rrugën për të arritur në qendër të qytetës... në vend të dy minutave, i duheshin 3 minuta për të arritur, dhe thoshte “na çmendën se e kemi të numëruar çdo minut, s’kemi kohë për të humbur!”). S’kishte faj i shkreti, me atë minut që humbi mund të bënte shumë gjëra të vjera!!! Pra, koha për secilin prej nesh ecën, vrapon si e çmendur dhe secili prej nesh e ka bindjen se koha e vet, sado që mundohemi ta kontrollojmë, ta organizojmë e të bëjmë siç duam vetë, i ikën nga duart, i rrëshqet, është diçka përtej nesh, që nuk varet nga ne. Akoma edhe më pak varen nga ne këto fenomene që do të shikojmë e do të analizojmë më në detaj, të cilat quhen Gjërat e fundit të njeriut. Po ç’janë këto gjëra se na çmende, na bëre kurioz tani?

Disa nga këto besoj se mund t’i marrim ndër mend sepse janë gjërat që i përkasin edhe arsyes njerëzore, por disa të tjera mund t’i kemi dëgjuar vetëm falë fesë, e më specifikisht sepse për këtë po flasim këtu, falë fesë katolike. Epo, ne do t’i analizojmë këto gjëra të fundit të njeriut jo vetëm nga ana njerëzore, e arsyes apo e jetës materiale, por do t’i shikojmë nga pikëvështrimi i fesë katolike. Kjo është shumë e rëndësishme sepse siç do të shikojmë, duke qenë gjëra që na përkasin dhe të gjithë pak a shumë kemi ndonjë ide apo ndonjë pre-koncept në lidhje me këto gjëra, mund të bëjmë konfuzion ose të rrezikojmë të themi “aaa këto qenkan ore, po i di këto gjëra unë, s’kam nevojë të më thotë gjë kush, dihen”.

### Çfarë janë gjërat e fundit të njeriut?

**Gjërat e fundit të njeriut janë gjërat e fundit me të cilat njeriu përballlet kur mbaron jeta e tij.** E këtu, pa humbur kohë se për ata që e dinë na është bërë si shok i ngushtë (për të mos thënë si bukë e djathë), dikush do të thotë “Nard Ndoka!”. Ç’na the?! Ok, nuk kam sqaruar kushedi se çfarë, por ky është “përkufizimi”! Le të vazhdojmë më tej...

Gjërat e fundit të njeriut në latinisht quhen *novissima* (që do të thotë “gjëra të fundit”), kurse në greqisht *éσχάτα*. Nga kjo fjalë greke vjen edhe termi tjetër “eskatologji”, që është doktrina që studion fatin, fundin e njeriut. Pra, gjërat e fundit të njeriut ose “*novissima*”, bëjnë pjesë në mësimet e eskatologjisë së krishterë.

### Gjërat e fundit të njeriut, sipas fesë katolike, janë katër:

1. Vdekja
2. Gjyqi
3. Ferri
4. Parajsa

Tani po që po futemi më thellësisht brenda argumentit! Pra, siç e shikoni, argumenti është me të vërtetë i rëndësishëm dhe me të vërtetë “spec djegës”. Këto çështje janë të gjitha që duhet t’ja kemi pyetur vetes, duhet të kemi menduar në lidhje me to, të paktën një herë në jetë, se mos më shumë: Çfarë është vdekja? A ka një gjyq pas vdekjes? Kush do të më gjykojë? Si do të gjykojem? Çfarë ka pas vdekjes? A ka jetë pas vdekjes? Ku do të shkoj pas vdekjes sime? A ekziston Parajsa? A ekziston ferri? Po Purgatori çfarë lidhje ka në këtë mes? Si mund të shkoj në Parajsë? Kush shkon në ferr? Eh, sa shumë pyetje! Prit, t’i marrim me radhë, se e kuptoj se janë tejet të rëndësishme për t’ju përgjigjur, por duhet të ecim dalëngadalë, duke i marrë me radhë, që të mundohemi të sqarojmë dyshimet e pikëpyetjet e shumta në lidhje me këto argumente. Do të fillojmë duke folur të parën: vdekja.

## BURIMET ZYRTARE

Përpara se të fillojmë, le të përmendim burimet zyrtare që janë siti zyrtar i Kishës Katolike vatican.va, siti i etërve domenikanë Amici Domenicani, me përgjigje të teologut Atë Angelo Bellon dhe siti i priftit italian Don Leonardo Maria Pompei: In Voluntate Dei.

## VDEKJA

**Vdekja është një ndër gjërat e fundit të njeriut**, listohet e para në këtë listë. Nqs do të na duhej të ndaleshim dhe të flisnim e të argumentonim mbi vdekjen, nuk do të mjaftonte 15 ditëshi i pushimeve të verës. Por, duke qenë se siç tha ai njeriu më sipër “i kemi minutat e numëruara”, le të ndalemi tek çështjet themelore në lidhje me vdekjen, gjithnjë nën këndvështrimin e krishterë, në lidhje me atë që na thotë Kisha Katolike, të cilën e kemi quajtur Nënë sepse na mëson e na udhëheq në errësirën e kësaj jete si një nënë e vërtetë.

Pyetja e parë është:

### 1. A ËSHTË NORMALE TË KEMI FRIKË NGA VDEKJA?

Nga se kemi frikë zakonisht? Ose nga diçka që ja vlen të kemi me të vërtetë frikë sepse na vë në rrezik (psh. nqs gjendemi përpara një luani të uritur në mes të xhunglës është krejt normale të kemi frikë, sepse me shumë mundësi do të na vërsulet, do të na hajë dhe ne do të vuajmë shumë e pastaj, do të vdesim). Është më pak normale që reagimin sikur të ishim para një luani ta kishim para një qeni Chihuahua që na kalon anash trotuarit, siç më ndodh mua psh, por nejse këtu futemi tek pjesa e psikologjisë (së çmendur do të thoja, flas për veten time eee) të secilit prej nesh. Ose kemi frikë nga e panjohura, sepse nuk e njohim, sepse nuk e dimë se si është, se ça ndodh, se ça na pret. Epo, **vdekja si fenomen futet tek diçka midis këtyre dy frikërave: midis frikës së rrezikut dhe frikës së panjohurës.** Por, ajo çka dua të bëj duke filluar nga sonte, duke filluar nga vetja ime, është që ta zhvendosim frikën që kemi më shumë nga e panjohura (se shumica prej nesh atë frikë kanë më shumë) drejt asaj të rrezikut, deri në tentativin (shpresoj jo të kotë) që ta zvogëlojmë këtë frikë sa më shumë e të zhvendosemi drejt frikës së rrezikut (do të shikojmë se për cilin rrezik flitet në të vërtetë) dhe në fund, edhe këtë të fundit, ta largojmë e ta shndërrojmë në diçka tjetër.

Këtë sigurisht nuk mund ta bëj unë, kjo është një mrekulli e vërtetë që vetëm Zoti mund të bëjë dhe mund të siguroj që me mua personalisht ka punuar shumë nga ky aspekt. Unë, e para, kam qenë një njeri që fjalën “vdekje” as nuk dua që ta përmendja, sepse më terrorizonte, doja ta shikoja si diçka sa më të largët të jetë e mundur. Kjo pak nga mënyra se si jam rritur dhe për shkak të një plage shumë të madhe në familjen time, nga ana e mamasë në veçanti, të shkaktuar pikërisht nga vdekja (më specifikisht e tezes sime në moshën 22 vjeçare në një aksident). Kam folur vetëm pjesërisht se


si Zoti e ka punuar dhe e ka shndërruar këtë pjesë të jetës sime në dëshminë personale që kam bërë (që mund ta gjeni në kanalën YouTube Dashuria nuk shuhet kurrë, nën titullin “Takimi im me Jezun Krishtin”).

**Pra, vdekja na frikëson të gjithëve dhe kjo është normale: kështu duhet të jetë.** Është e kotë që në Gjermani apo në këto vendet “e përparuara” (ashtu thonë) të bëjnë kurse duke i përgatitur fëmijët që të vegjëll mbi vdekjen, duke u folur mbi vdekjen sikur të ishte diçka normale, natyrale e njeriut: “të gjithë vdesim fëmijë të dashur, edhe ti do vdesësh herët a vonë, mos u shqetëso, është krejt normale, s’ka asnjë problem, vdes e mbaron puna”. Ajo që e quajnë “*death education*”. Tani, më falni se po i banalizoj pak “vullnetarisht” (jam pak e keqe e di) por është e kotë që të mundohen psikologët, antropologët, sociologët, mjekët, filozofët e shtoni kë të doni në këtë listë që të mundohen të heqin frikën e vdekjes duke e konsideruar vdekjen si diçka normale në jetën e njeriut, edhe pse mund t’ju duket se me atë lavazh truri kanë arritur diçka në mendjen e tyre, në zemrën e tyre nuk do të mund ta heqin kurrë këtë frikë. Pse? Sepse vdekja nuk është diçka normale në jetën e njeriut. Po! Fakti që të gjithë ne, herët a vonë, vdesim, nuk do të thotë që kjo është normale. Ne jemi të gjithë anormalë?! Po çfarë po thua?!

Atëhere, dua të them që këtë çështje, sado që të mundohesh ta shikosh në një këndvështrim s’po them ateist, por të paktën laik, pra dmth që kanë të bëjnë vetëm me këtë jetë, pa menduar a ka jetë më tej apo jo, nuk mund ta ndash dhe nuk mund ta shikosh të ndarë nga çështjet e tjera që i përkasin gjërave të fundit të njeriut. Po ashtu, nuk mund ta shikosh pa patur të qartë objektivin final të jetës sonë, pra horizontin tonë, destinacionin tonë, aty ku duam të shkojmë. Por jo vetëm kaq, këtë çështje, pra vdekjen, nuk mund ta shikojmë e as ta analizojmë pa patur të qarta çështjet e kundërta të saj, që janë çështjet e fillimit të jetës sonë. **Pra, ne nuk mund ta kuptojmë vdekjen, dmth fundin e jetës sonë, pa patur të qartë përpara fillimin e jetës, dmth ngjizjen tonë dhe mbi të gjitha identitetin tonë: pra kush jemi, nga ku vijmë, si jemi të gatuar, si jemi të ndërtuar.** Atëhere më falni nëq do t’ju duket pa lidhje, por, për të kuptuar vdekjen në këndvështrimin e krishterë, do të më duhet të tregoj se kush është njeriu dhe si është konceptuar e krijuar ai nga Zoti, pra për të kuptuar fundin e njeriut, duhet të shkojmë tek fillimi i tij.

## 2. KUSH ËSHTË NJERIU?

**Qënia njerëzore është e përbërë nga dy elemente: shpirti dhe trupi, që janë në unitet midis tyre.**



### TRUPI I NJERIUT

Trupi i njeriut është ai që të gjithë ne e shohim, e prekim. **Ne mund ta shohim e ta prekim trupin tonë sepse trupi është një realitet material e sytë tonë janë të krijuar të tillë që mund të shohin vetëm realitetet që i përkasin botës materiale** (pra sytë tanë mund të shohin trupin tonë, një lule, diellin që lind, një fëmijë që luan futboll, një makinë që ecën me shpejtësi sepse të gjitha këto i përkasin realiteteve materiale).

Trupi i secilit prej nesh e ka origjinën në zigotën, e përbërë nga gametet mashkullore dhe femërore. Pra, babai dhe nëna jonë biologjikë japin gametet e tyre dhe gjatë ngjizjes, kemi fekondimin e vezës nga ana e spermatozoit. **Ky fenomen, që krijon zigotën e cila shënon fillimin e një jete njerëzore, e cila pastaj nëpërmjet zhvillimit embrional në**

**barkun e nënës dhe zhvillimin më tej kur të dalë në dritë lind nga bashkëpunimi i prindërve me veprën krijuese të Zotit (prandaj quhet ndryshim “prokrijim”).** Por, prindërit biologjikë, edhe pse nuk duam ta reduktojmë sepse ky është një bashkëpunim i mrekullueshëm dhe i një dinjiteti tejet të lartë për njeriun me veprën krijuese, japin pra vetëm gametet e tyre dhe as nuk ja kanë idenë se si këto gametë janë të krijuar, janë të përbërë, se si e tek. Pra, nuk janë ato që i kanë krijuar, as të vetët, as edhe ata të fëmijës së tyre që e ngjizin, ata vetëm i dhurojnë lirisht gjatë kopulës (aktit të marrëdhënies seksuale).

## SHPIRTI I NJERIUT

Shpirti i njeriut nuk mund të shihet me sytë tonë të trupit, sepse e thamë që sytë tonë janë të gatuar të tillë që mund të shikojnë realitetet materiale vetëm. Por, vetëm sepse shpirti ynë nuk mund të shikohet dhe të preket, të shijohet etj nëpërmjet shqisave njerëzore kjo nuk do të thotë që nuk ekziston. Përkundrazi, shpirti i njeriut ekziston. Çdo njeri i kësaj bote përveç trupit, ka edhe shpirtin.

### a. Si e dimë që njeriu ka një shpirt?

Ne e dimë që njeriu ka një shpirt jo nga feja, pra kjo temë e ekzistencës së shpirtit nuk i përket fesë, por bën pjesë në ato që quhen “gjërat që paraprijnë fenë (*praembulum fidei* në latinisht)”. Kjo sepse përfundimi që njeriu ka një shpirt mund të arrihet edhe vetëm nëpërmjet arsyes, pa patur nevojë që të kemi fenë ose ndonjë përkatësi fetare. Për këtë arsye, Aristoteli (384 para Krishtit), pra kuptohet jo i krishterë se Krishti as që ishte mishëruar si njeri në atë kohë, shkruan në shkrimin e tij “*De anima*” duke vështuar me kujdes kufomën e një njeriu të vdekur, që ndryshe nga kjo qenie njerëzore e vdekur, në qenien njerëzore të gjallë gjendet principi jetësor (në greqisht *ànemos* dhe në latinisht *anima*), e cila sigurisht nuk gjendet në njeriun e vdekur. **Ky princip jetësor, e ashtuquajtur *anima*, është ai që ne quajmë në shqip shpirti.**

**Shpirti është principi jetësor i trupit, ai që i jep jetë trupit.**

### b. Nga kush krijohet shpirti?

Shpirti i njeriut krijohet nga Zoti.


### c. Nga se krijohet shpirti?

Zoti e krijon shpirtin e njeriut nga hiçi (është Zoti, e ka fuqinë ta bëjë këtë, sikurse ka krijuar botën nga hiçi).

### d. Kur krijohet shpirti?

**Zoti e krijon shpirtin e njeriut**

**çastin e ngjizjes**, pra në momentin që veza fekondohet nga spermatozoi dhe formohet zigota, qeliza e parë e një qenieje njerëzore.



Shpirti nuk krijohet më përpara (sikurse mendonte gabimisht Platoni, sikur të ishte një “laborator” i shpitrave njerëzore që presin të futen në ndonjë zigohtë) e as edhe një sekond më mbrrapa ngjizjes, por pikërisht në momentin e ngjizjes (Zoti është Zot, mund ta ketë këtë saktësi të jashtëzakonshme) dhe e “fut” (më falni nuk më vinte një term më i përshtatshëm, termi i huaj i duhur do të ishte “*infusion*”) në zigohtë në po atë çast ekzakt të ngjizjes.

#### e. Cilat janë fuqitë e shpirtit?

Fuqitë, ose sikurse thuhet ndryshe fakultetet, e shpirtit janë inteligjenca dhe vullneti. Kujdes! Kemi disa paragjykime dhe mënyra të menduarit njerëzore në lidhje me inteligjencën dhe vullnetin. Por, duhet të specifikojmë që inteligjenca e shpirtit nuk është vetëm ajo që mendojmë ne kur themi “ky njeri është shumë inteligjent” etj. Inteligjencën e ka çdo qenie njerëzore dhe është fuqia e shpirtit me anë të së cilës njeriu arsyeton (truri është elementi material, që mbledh informacionet dhe imazhet, por nuk është ai që vë në vepër arsyetimin). Arsyetimin njerëzor e vë në punë kjo fuqi e shpirtit që quhet inteligjenca. Atëhere, çdo njeri, duke qenë se është “i pajisur” me shpirt, është i pajisur edhe me inteligjencë. Nuk do të flasim tani më tej për këto dy fuqi të shpirtit, por e përmenda inteligjencën dhe karakteristikën e njeriut e të qenit racional (qenie që mendon, që arsyeton pra) sepse do të na shërbejë më poshtë.

## 2. SI ËSHTË KRIJUAR NJERIU NGA ZOTI: I VDEKSHËM APO I PAVDEKSHËM?

**Njeriu është krijuar nga Zot jo për vdekjen, por për jetën. Trupi dhe shpirti, që janë në një unitet, një njësi e vetme pra, janë krijuar nga Zoti për të mos vdekur kurrë.**

Çka do të thotë kjo?

### PAVDEKSHMËRIA E SHPIRTIT TË NJERIUT

**Shpirti i njeriut është shpirtëror dhe i pavdekshëm.**

Pra, e përsërisim, shpirti i njeriut i krijuar nga Zoti është I PAVDEKSHËM. Do të ishte një temë shumë e gjatë për ta argumentuar, përveçse tejet e bukur dhe interesante. Mjafton të themi disa gjëra kryesore. Duhet të themi që pothuaj të gjithë filozofët kanë folur për shpirtin dhe pohojnë me plot gojën që shpirti është i pavdekshëm. Këtu e kam fjalën edhe për filozofë jo të krishterë, përbiles për filozofë që kanë jetuar para lindjes së Krishtit. Si ka mundësi që e kanë thënë që atëhere, si e dinin? Sepse çështja e pavdekshmërisë së shpirtit të njeriut (sikurse ajo e ekzistencës së vetë shpirtit) nuk i përket fesë, por i përket arsyes. Kjo do të thotë që nuk është e nevojshme që të jemi të krishterë, apo fetarë apo besimtarë për të arritur në përfundimin që shpirti i njeriut është i pavdekshëm, sepse ky përfundim arrihet edhe vetëm nëpërmjet arsyes njerëzore.

#### a. Si mund ta themi që shpirti i njeriut është shpirtëror?

Thamë që shpirti i njeriut është shpirtëror së pari, kurse trupi i njeriut i përket botës materiale. Ky është një ndryshim themelor dhe nga ky ndryshim duhet të nisim për të kuptuar pavdekshmërinë e shpirtit. Anima (lat.) pra shpirti është shpirtëror sepse e tejkalon, kalon përtej (thuhet me termin ekzakt “*transcendental*”) materies. Jo në kuptimin fizik të fjalës, sikurse ne psh. kalojmë përtej një ndalesë për të shkuar tek një tjetër kur po ecim me tren, por në kuptimin metaforik.

Për të bërë ca shembuj, që ta kuptojmë, aktivitete të qënies njerëzore që i përkasin shpirtit, që i kryen shpirti, janë psh. që njeriu përpunon, programon, mendon, krijon ide nëpërmjet gjërave dhe informacioneve që merr nga shqisat (e thamë më sipër që shqisat i përkasin botës materiale, dmth asaj bote që mund të shihet, mund të preket, shijohet, nuhatet etj). Pra, mund të themi që shpirti nëpërmjet këtyre aktiviteteve shkon përtej (fjala latinisht “trascendere”) materies, e tejkalon materien, botën materiale. **Pra, shpirti (në lat. anima) është realitet shpirtëror, jo material, nuk i përket botës materiale.** Pra, njeriu edhe pse jeton në botën materiale, në botën e shqisave me të cilat jemi në kontakt, që është bota që na rrethon e në të cilën aktualisht jetojmë, vazhdimisht shkon përtej saj, e tejkalon atë (trascendere). Si? Nëpërmjet vendimeve që merr, nëpërmjet aftësisë programuese, nëpërmjet marrëdhënieve me të tjerët ku nëpërmjet elementeve të botës materiale vihet në kontakt e në bashkim me njerëz që jetojnë në vende e në kulturë të tjera, përbiles edhe në kohë të tjera etj. Pra, **qënia njerëzore nëpërmjet shpirtit njerëzor që është realitet shpirtëror shkon përtej përmasave të kohës e të vendit.**

**Shembull.** Edhe kafshët janë të përbëra nga trupi dhe shpirti (anima) por shpirti i kafshëve nuk është shpirtëror, por quhet sensitiv pra i lidhur me instiktet e shqisat. Duke qenë shpirti i kafshëve vetëm sensitiv dhe jo shpirtëror, ata nuk mund të shkojnë përtej materies. Konkretisht, psh ca mace që jetojnë në Shqipëri nuk mund të flasin midis tyre për “shoqet” e tyre mace që jetojnë në Itali, në mërgim. As nuk mund të flasin për ca mace të tjera shqiptare që mund të kenë jetuar para ca vitesh në po atë vend. Kurse njeriu mund t’i bëjë këto gjëra, mund të shkojë përtej asaj që shikon, prek, dëgjon e nuhat në këtë moment, pra mund të shkojë përtej materies, sepse shpirti i njeriut është realitet shpirtëror.

Mund të duken banalitete, por nuk janë. Mjafton të ndalemi pak sekonda, të arsyetojmë seriozisht por pa e lodhur shumë trurin (sepse e shikojmë se janë gjëra krejt të arsyeshme gjërat për të cilat po flasim deri tani, nuk kemi nevojë ta “shqetësojmë” fenë tonë, mjafton të vëmë në punë arsyen njerëzore që e kemi të gjithë, pa përjashtim).

E kështu edhe Platoni e kishte kuptuar (duke arsyetuar, se filozofët sidomos përpara s’bënin gjë tjetër veç duke menduar ditë e natë) që në ato kohë (viti 428 para Krishtit) shumë mirë se shpirti ishte së pari realitet shpirtëror (për arsyet që dhamë më sipër) e së dyti realitet i pavdekshëm.

Atëhere, Platoni e Ciceroni me shokë e kishin kuptuar që shpirti është realitet shpirtëror, dhe I pavdekshëm, por e pyesnin veten, se nga vinte ky realitet? E bënin hipotezat e tyre. Filozofët pas atyre kanë reflektuar gjatë dhe kanë kuptuar që shpirti, pikërisht sepse i përket një realiteti që ne as e shohim, as e prekim. Atëhere, shpirti vjen direkt nga Zoti, pra është i krijuar direkt nga Zotin, në mënyrën dhe në çastin që përmendëm më sipër.

#### **b. Si arrihet nga ky fakt tek pavdekshmëria e shpirtit?**

Nuk është e vështirë që të kuptohet. Çfarë vdes? Kur pjesët e një diçkaje nuk funksionojnë më mirë dhe nuk harmonizohen në një farë mënyre me tërësinë e pjesëve, atëhere kjo “diçka” prishet, shkatërrohet, vdes. Mund ta themi këtë gjë për çdo gjë që është e përbërë nga pjesë të ndërlidhura fort me njëra tjetrën, por të ndashme: kjo vlen për një makinë, për një televizor, si edhe për trupin e gjallesave, të kafshëve por edhe të njeriut. Edhe trupi i njeriut mund të themi që është një makinë, edhe pse shumë më komplekse, më perfekte dhe më e ndërlikuar se çdo lloj makine në këtë botë, por është si një punë makine, e përbërë nga disa pjesë, që janë organet e tij përbërëse. Kur këto pjesë fillojnë e prishen (ne themi sëmuren) dhe nuk funksionojnë më mirë midis tyre, nuk bashkëpunojnë më mirë sepse janë të konsumuara, të prishura, të sëmura në rastin e njeriut, e gjithë makina (në rastin e njeriut trupi i njeriut) prishet, shpërbëhet, pra ne themi vdes.

Por, nuk mund të themi të njëjtën gjë për atë realitet që është shpirtëror sikurse është shpirti i njeriut. **Shpirti i njeriut është shpirtëror, pra jo material e dmth nuk është i përbërë nga pjesë materiale të ndryshme të cilat mund të prishen dhe të shpërbëhen. Pra, shpirti i njeriut nuk mund të vdesë sepse është realitet shpirtëror.** Pra, shpirti jo vetëm që është i pavdekshëm, që nuk vdes kurrë, por në fakt as nuk mund të vdesë (edhe sikur për absurd, por nuk është një hipoteze shumë absurde dhe do të shohim më tej se pse, të donte ose të vendoste që të vdiste). Edhe sikur një njeri të vetëvritet, pra do të vdesë, t'i heqë jetën vetes dhe e bën këtë gjë, prapë se prapë nuk mund ta vrasë shpirtin, sepse shpirti e përsërisim, është realitet shpirtëror, e tejkalon materien dhe është i pavdekshëm. **Shpirti i njeriut është krijuar nga Zoti i tillë dhe asnjë nga ne nuk mund ta ndryshojë këtë gjë.**



Kjo do të thotë, të dashur miq, vëllezër e motra, që shpirti i secilit prej nesh është i pavdekshëm; shpirti i secilit prej nesh nuk do të vdesë kurrë, kurrë, kurrë, edhe pas vdekjes së trupit tonë (e thamë pak më sipër që trupi mund të vdesë e se pse). Prandaj, të rrimë të qetë se këtë çështje e kemi mbyllur përfundimisht:

**SHPIRTI I SECILIT PREJ NESH, QËNIEVE NJERËZORE, ËSHTË I PAVDEKSHËM.**

**PËRFUNDIMI:**

**SHPIRTI I NJERIUT ËSHTË REALITET SHPIRTËROR.**

**SHPIRTI I NJERIUT ËSHTË I PAVDEKSHËM.**

### **TRUPI I NJERIUT: I VDEKSHËM APO JO?**

Prit tani, na bëre pak konfuz në lidhje me trupin e njeriut. Për shpirtin e kuptuam dhe e morëm vesh mjaft mirë. Por për trupin më duket se na the dy gjëra që kundërshtojnë njëra tjetrën: në fillim na the që trupi (sikurse shpirti) është krijuar nga Zoti për të mos vdekur, kurse pak më sipër the që trupi duke qenë material dhe i përbërë nga pjesë mund të vdesë. Cila është e vërteta?

Të dyja. Të dyja gjërat janë të vërteta dhe nuk kundërshtojnë njëra tjetrën nqs e lexoni me vëmendje.

Zoti, kur e ka menduar njeriun në mendjen e tij, e ka menduar që ta krijojë të tillë që të mos vdesë kurrë. Cila ka qenë ideja e Zotit? Që Zoti ta krijojë njeriun (të përbërë nga trupi e shpirti), ta vërë në këtë botë që nëpërmjet fesë të njohë, të dojë e të shërbejë Zotin dhe pastaj, pasi të përmbillet periudha e tij në tokë, në të ashtuquajturën Parajsë tokësore, ta marrë me vete njeriun në Parajsë ashtu sikurse e ka krijuar, pa kaluar nëpër vdekjen, pra ta marrë me trup e me shpirt. Shkurt, ZOTI

## **NUK E KA KRIJUAR NJERIUN PËR TË VDEKUR, AS SHPIRTI E AS TRUPI I TIJ, POR PËR TË JETUAR PËRGJITHMONË.**

Ou, interesante! Po si ka mundësi atëhere që ne vdesim, ose më mirë ta specifikojmë tani se e kuptuam, që trupi ynë vdes?

E para duhet të dallojmë midis pamundësisë për të vdekur ose jo. Atëhere, shpirti i njeriut e thamë më sipër, e ka të pamundur të vdesë duke qenë realitet shpirtëror, jo material.

Përkundrazi, trupi i njeriut duke qenë realitet material, në këtë botë e ka të mundur që të vdesë. Pra, e ka të mundur, por Zoti, edhe pse e ka të mundur që të vdesë, nuk ka dashur që të vdesë as trupi e prandaj ka qenë menduar e tillë që sapo të mbaronte periudha në “parajsën tokësore”, të shkonim tek Zoti, Krijuesi ynë, me shpirt (që e ka të pamundur të vdesë) e me trup (që do e kishte pasë të mundur të vdiste, por në fakt nuk do të vdiste për vullnet të Hyjit).

### **PO ATËHERE, PSE VDES TRUPI I NJERIUT?**

Përgjigjen e gjejmë në Bibël:

*“Për këtë arsye, sikurse me anë të një njeriu mëkati hyri në botë e, me anë të mëkatit, vdekja, dhe kështu vdekja kaloi në të gjithë njerëzit, sepse të gjithë njerëzit mëkatuan”.* (Letra drejtuar Romakëve, 5, 12).

Shumë e qartë fjalja e Shën Palit, por le ta analizojmë në detaj. Vdekja (e trupit) e njeriut ka hyrë në botë për shkak të mëkatit, pra ne vdesim, secili njeri në botë, e secili nga ne kur t’i vijë koha vdesim për shkak të mëkatit. Cilit mëkat? Mëkatit origjinal.

**Pra, vdekja e trupit ndodh për shkak të mëkatit origjinal!** Kujdes! Mos t’i ngatërrojme shkaqet biologjike, me të cilat merremi ne mjekët (e kam thënë disa herë që jam mjekë) të vdekjes së trupit të njeriut, si psh arresti i qarkullimit të gjakut, arresti respirator etj (që janë shkaqet që shkencat mjekësore mund t’i studiojnë e t’i perfeksionojnë në njohurinë e tyre gjithnjë e më shumë). Ne po flasim për pse-në e vdekjes. Pse ne vdesim, por nga ana e origjinës së vdekjes, e shkakut më të thellë të saj, jo të shkakut biologjik që i përket shkencës mjekësore dhe botës materiale. Ne këtu na intereson shkakun më të thellë, nën këndvështrimin e krishterë. Kisha Katolike (me këto themele biblike që sapo i pamë) na thotë që trupi i njeriut (i cili e përsërisim sipas vullnetit të Zotit nuk duhej të vdiste) vdes sepse në botë, e dmth në secilin prej nesh, ka hyrë mëkati origjinal, mëkati i progjenitorëve tanë, të famshmit Adami dhe Eva. Mos! Për shkak të mëkatit që kanë bërë dy njerëz që as i kam njohur kurrë në këtë botë vdes edhe unë, që jetoj pas mijëra e mijëra vitesh nga vdekja e tyre? Po ç’a lidhjeje kam unë me to? E si u fut në mua mëkati origjinal? T’i marrim me radhë.



Kemi thënë që qenia njerëzore krijohet në momentin e ngjizjes: në momentin kur spermatozoi mashkullor fekondon qelizën femërore (vezën), lind zigota, që është qeliza e parë e qënies njerëzore. Po në atë çast, menjëherë, Zoti “fut” shpirtin e këtij njeriu të veçantë dhe unik në botë,


kjo qenie njerëzore e përbërë nga ana materiale (fillimi i zhvillimit të trupit të tij) nga zigota e nga ana shpirtërore nga shpirti. Ky është njeriu, kështu jemi krijuar secili prej nesh! Dhe për Zotin do të kishte qenë mirë kështu, nqs nuk do të kishte ndodhur diçka. Çfarë?

Që këta dy njerëz të parë, Adami e Eva, kanë mëkatuar, duke mos ju bindur Zotit (i cili u kishte thënë të mos hanin nga pema e së keqes e së mirës) dhe duke “ngrënë” nga kjo pemë. Tani, nëpër piktura kjo simbolizohet me mollën e famshme që hanë Adami e Eva, të tunduar nga djalli që simbolizohet nga gjarpri, por përveç simbolizmave që përdoren për të treguar në mënyrë figurative këtë ngjarje të vërtetë e kaq të rëndësishme që ka ndodhur në fillimet e njerëzimit, esenca e “ngrënies së këtij fryti të ndaluar” është që Adami e Eva nuk i janë bindur fjalës së Zotit dhe kanë bërë sipas mendjes së tyre. Çka ka ndodhur? T’jua them me pak fjalë: Zoti ua ka thënë: “O njerëz, o budallenj, o kafshë (nuk u ka thënë kështu, por po le të shfryjmë pak inatin me Adamin dhe Evën që na e kanë shkaktuar këtë tmerr) mos e bëni, mos bini në këtë tundim djallëzor, sepse do të vdisni!!!”. Kjo pra ishte pema e famshme e mollës, pema e së keqes e së mirës: që Adami dhe Eva vendosin të njohin edhe të keqen e mundshme që mund t’i ndodhë njeriut sikur të largohet nga ligjet e Zotit, sikur të mos i bindet atij. E kështu ndodhi. Ato kryen mëkatit (e ashtuquajtur origjinal), “ranë” nga Parajsa tokësore (po i biem shkurt se për tani nuk na interesojnë këto detaje) dhe si pasojë e kësaj rënieje gjendej edhe vdekja (edhe pasoja të tjera të këqija por tani s’po ndalemi). E nënkuptuar vdekja e trupit të njeriut. Pse pra? **SEPSE TRUPI E KISHTE TË MUNDUR TË VDISTE** (duke qenë realitet material i përbërë nga pjesë që mund të shpërbëhen) **POR ZOTI NUK DONTE QË ADAMI E EVA TA NJIHNIN KËTË REALITET, DMTH QË TË NJIHNIN VDEKJEN E MUNDSHME TË TRUPIT. NËPËRMJET MOSBINDJES DMTH MËKATIT TË TYRE, ATA (DHE SË BASHKU ME TA EDHE NE TË GJITHË) E NJOHËM KËTË REALITET TË MUNDSHËM TË TRUPIT: VDEKJEN E TIJ.** Imagjinoni, **Zoti u kishte dhënë Adamit e Evës dhuratën preternaturale të imunitetit nga vdekja e trupit**, dmth e përsërisim Adami e Eva (e kështu pastaj të gjithë ne të tjerët, pasardhësit e tyre) nuk do ta kishin njohur kurrë vdekjen trupore, nqs nuk do të kishin mëkatuar.

Alamet fitimi, alamet njohurie morën Adami dhe Eva eee!

Po mirë ata deshën me e marr këtë “alamet njohurie”, po ne të shkretët, pasardhësit e tyre, çka lidhje kemi? **Pse edhe ne e kemi marrë këtë njohuri, pra pse edhe trupat tanë vdesin?**

Duke qenë se Zoti na ka krijuar të gjithëve në një unitet, në një familje të madhe njerëzore, të ndërlidhur me njëri tjetrin, atëhere sikurse ne duhej të trashëgonim nga Adami dhe Eva gjenet dhe gjërat e tjera materiale, kështu marrim në trashëgimi (alamet trashëgimie!), na transmetohet për trashëgimi edhe mëkati i tyre origjinal (që nuk është mëkat yni personal, pra s’kemi asnjë faj për të, por është mëkati trashëguar) dhe së bashku me të edhe pasojat e tij, dmth vdekja.



Atëhere, ja vlen të përmendim që Zoti e krijon çdo krijesë njerëzore perfekte, pas asnjë njollë, dmth pa asnjë mëkat. Shpirti i secilit prej nesh krijohet nga Zoti perfekt. Në po atë çast të futjes së shpirtit në zigo të (formimi i zigo tës, krijimi i shpirtit dhe infuzioni e shpirtit për t'u bërë një unitet me zigo tën ndodhin në të njëjtin çast), futet në ne, më saktë në shpirtin tonë të krijuar nga Zoti perfekt, futet për trashëgimi nga Adami e Eva, mëkati origjinal.

Mëkati origjinal futet si një njollë në shpirtin e njeriut, i krijuar nga Zoti i bardhë e i pastër si bora (po flasim me analogji) dhe njollos shpirtin e çdo njeriu duke i lënë pasojat (do i shikojmë ndonjë herë tjetër cilat) shpirtit, por edhe trupit. Pasojat kryesore që mëkati origjinal lë në trupin tonë është fakti që trupi ynë sëmurët, dobësohet, plakët dhe në fund vdes. Pra,

### CILAT JANË PASOJAT E MËKATIT ORIJINAL PËR TRUPIN E NJERIUT?

### SËMUNDJA, PLAKJA DHE VDEKJA E TRUPIT JANË PASOJA TË MËKATIT ORIJINAL.

Atëhere, ne vdesim (trupi ynë vdes):

- *E para sepse mund të vdesë (ndryshe nga shpirti) duke qenë realitet material dhe I përbërë nga pjesë që mund të prishen e shpërbëhen midis tyre*
- *E dyta, kjo ndodh realisht (edhe pse Zoti nuk e ka krijuar trupin që të vdesë) për shkak të trashëgimisë në shpirtin tonë të mëkatis origjinal*

Tani, pasi i analizuam të gjitha elementet që nga ngjizja, pra që nga fillimi jetë, i ekzistencës së një qenieje njerëzore, mund të themi çfarë është vdekja:

## **VDEKJA ËSHTË SHKËPUTJA E SHPIRTIT NGA TRUPI.**

Duke qenë se trupi, për shkaqet e mësipërme, në njëfarë pike të jetës sonë, për ndonjë arsye a tjetër (mund të jenë shkaqe si plakja, sëmundja, aksidentet e ndryshme, ose edhe vrasja, vetëvrasja, eutanasia etj) vdes, dmth nuk është më i aftë që shpirti t'i japë jetë atij, shpirti menjëherë shkëputet nga trupi.

Është e vështirë për ta përcaktuar me saktësi absolute çastin e vdekjes trupore. Zakonisht konsiderohet i vdekur kur ka vdekur çdo pjesë e trurit, pra kur elektroencefalograma është rrafsh për më shumë se 6 orë.

Atëhere, le të lidhemi me fillimin e këtij rrugëtimi:

### **A është normale që të kemi frikë nga vdekja?**

Po. Është normale sepse vdekja nuk është pjesë e natyrës sonë njerëzore. Pra, vdekja, edhe pse ndër vite e ndër shekuj që sikurse e thamë që në fillimet e njerëzimit jemi mësuar kështu, dmth me vdekjen, që njerëzit vdesin e prandaj këto kurset e psikologët e famshëm duan ta bëjnë një fenomen normal nëpërmjet death education e budallëlliqe të tilla, kurrsesi nuk do ta arrijnë ta bëjnë e ta bindin njeriun në thellësinë e tij për normalitetin e vdekjes sepse vdekja nuk është diçka normale. Pra, ne nuk jemi krijuar nga Zoti për të vdekur e duke qenë se nuk jemi gatuar të tillë, edhe pse njerëzit e së bashku me ta të gjithë ne vdesim e do të vdesim kur të na vijë kohë, nuk mund ta konsiderojmë normale vdekjen e nuk do të kemi kurrë një reagim normal ndaj vdekjes. Këtë e tregon edhe instikti natyral i çdo njeriu (në gjendje psikologjike e shpirtërore të shëndetshme) që deri në momentin e fundit e do jetën dhe do të mbijetojë, pavarësisht nga gjithçka e pavarësisht nga vuajtjet, vështirësitë e të këqijat e jetës etj. Sepse ne jemi krijuar për jetën, jo për vdekjen, dhe prandaj është krejt normale që të mos e duam vdekjen, që ta urrejmë, që të mos e pranojmë vdekjen: **NUK JEMI KRIJUAR PËR TË VDEKUR.**

Kjo është përgjigja e parë dhe më instiktive, edhe mjaft e vërtetë. Tani, le ta bëjmë prapë këtë pyetje, pasi i kemi lexuar e mësuar me vëmendje gjërat e thëna më sipër:

### **A është normale që të kemi frikë nga vdekja?**

Jo. Po si?!?!? Na çmende? E njëjta pyetje, dy përgjigje të kundërta?! Po, sepse po e shikojmë nga dy këndvështrime të ndryshme, por që e plotësojnë njëri tjetrin dhe që mbi bazën e cilit këndvështrim marrim, prodhohen përgjigje të ndryshme. Pra, nqs nga njëra anë, për faktin se si jemi krijuar nga Zoti, vdekja instiktivisht është diçka nga e cila kemi frikë, që e urrejmë, që nuk e duam etj; nga ana e këndvështrimit tjetër, pra që vdekja është THJESHT shkëputja e shpirtit nga trupi (i cili ky i fundit vdes, jo shpirti), nuk duhet të kemi aspak frikë nga vdekja, sepse në fund të fundit, nuk është asgjë. Dmth, në fakt, në fund të fundit, ne nuk vdesim me vdekjen trupore. Vdes trupi ynë i shkretë (e na vjen keq se e kemi dashur dhe na ka ndihmuar në këtë jetë, por do të shohim pastaj që edhe ky do ringjallet) por nuk vdesim ne, dmth shpirti ynë. Pra, personi ynë, kujtimet tona, dashuria jonë, lidhjet tona, mendimet tona, veprat tona të mira e të këqija janë kryer materialisht nga trupi, por në fakt komandën, vendimin e gjithçka tjetër ja ka dhënë shpirti ynë, e ai është i përjetshëm, është i pavdekshëm, prandaj shpirti ynë nuk vdes, e duke qenë shpirti ynë esenca jonë, ajo çka jemi në të vërtetë ne, intelekti, vullneti e memoria jonë gjenden tek shpirti, pra gjithçka e

qënies sonë është pjesë e shpirtit, dmth shkurt ne nuk vdesim kurrë. Atëhere, a duhet të kemi frikë nga vdekja, e nënkuptuar si vdekje e trupit, si vdekje trupore? Jo, sepse ne nuk prek aspak, vetëm vuajmë pak para vdekjes (agonia e vdekjes), pastaj parametrat vitalë nuk janë më të vlefshëm, mjekët na përcaktojnë vdekjen e trupit tonë biologjik, material dhe ndërkohë shpirti ynë shkëputet nga trupi. Kaq. Por ne jemi, vazhdojmë të ekzistojmë sikurse ekzistonim pak çaste para këtij episodi final te jetës sonë dmth të vdekjes trupore, qënieja jonë njerëzore, unë Marilda si njeri që mendoj, arsyetoj, dua etj vazhdoj të ekzistoj.

Ok, vdiq njeriu, pra u shkëput shpirti nga trupi Dhe ç'a bën shpirti i njeriut dmth? Ç'a ndodh pra? Rri ashtu, përpjetë, pezull? Rri si fantazmë? A ekzistojnë fantazmat? Rri akoma në këtë botë apo ku shkon, ç'a bën???

Do ta shikojmë herën tjetër...

Ju falenderoj dhe le ta mbyllim me një lutje ndaj Shën Jozefit për ata që vdesin, të cilën ju ftoj ta bëni përherë për shpirtat e njerëzve që vdesin (tani e dimë që vdesin në kuptimin që trupi i tyre vdes, por në fakt nuk vdesin kurrë):

**O SHËN JOZEF, ATË PUTATIV I JEZU KRISHTIT DHE FATI I VËRTETË I MARISË VIRGJËR, LUTU PËR ATA QË VDESIN SOT/SONTE. AMEN.**

